

**“ GENER-2 ” Sh.p.k.
MAMURRAS, LEZHE**

**AUDITIMI PASQYRAVE FINANCIARE
PER PERIUDHEN 1 JANAR- 31 DHJETOR 2017**

Tirane 5 Prill 2018



RAPORTI I AUDITUESIT

**Pronareve te Shoqerise “ Gener 2”
Mamurras, Lezhe**

Opiniononi

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “ GENER 2” sh.p.k Mamurras, Lezhe, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parase për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shenime të tjera lidhur me to.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare të përgatitura, me një besueshmeri të arsyeshme japin një pamje të vertete dhe të sinqerte për pozicionin financiar të shoqërisë “GENER 2” sh.p.k Mamurras me 31 Dhjetor 2017, të performancës financiare dhe flukseve të parave për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.



FILTO AUDITING sh p k

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin e shoqërisë, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e pershtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë të auditimit.

“FILTO Auditing” sh p k

Tirane, me 5 Prill 2018

Tatjana FILTO



GENER 2 sh.p.k

NIPT: K58615301M

PASQYRAT FINANCIARE

**TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME
STANDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR
VITI I MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017**

Permbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR më 31 Dhjetor 2017	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT	6
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7
1. Informacion i Përgjithshëm	7
2. Politikat kryesore kontabile	8
3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve të bilancit	13
4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	13
5. Inventare	13
7. Llogari të arketueshme (Klientet)	14
8. Të tjera të arketueshme	14
9. Aktive afatgjata materiale	15
10. Aktive afatgjata jomateriale	16
11. Huatë afatshkurtra	16
12. Detyrime ndaj shtetit	16
13. Të tjera detyrime afatshkurtra	17
14. Shitjet neto	17
15. Të ardhura të tjera	17
16. Mallra lende të para dhe shërbime	17
17. Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit	18
18. Shpenzime të personelit	18
19. Amortizimi dhe zhvlerësimet	18
20. Të ardhura dhe shpenzime nga interesi	19
21. Fitim / humbjet nga kursi i kembimit	19
22. Llogaritja e tatimit mbi fitimin	19
23. Vijimesia	19

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR më 31 Dhjetor 2017

AKTIVET	Shënime	Viti 2017	Viti 2016
I. Aktivet afatshkurtra			
1. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	4	248,546,471	192,423,375
2. Aktive financiare afatshkurtra		1,183,846	1,315,477
3. Inventari	5	801,462,174	1,150,727,772
4. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	6	844,508,590	427,728,374
5. Llogari te arketueshme	7	2,939,509,006	5,934,063,741
6. Te tjera te arketueshme	8	5,811,439	5,190,877
Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)		4,841,021,525	7,711,449,616
II. Aktivet afatgjata			
1. Investimet financiare afatgjata		383,035,200	383,035,200
2. Aktive afatgjata materiale	9	5,720,842,547	2,469,103,521
3. Aktive afatgjata ne proces		-	-
4. Aktivet afatgjata jomateriale	10	736,727	1,105,088
5. Aktive të tjera afatgjata		-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		6,104,614,474	2,853,243,809
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		10,945,636,000	10,564,693,425
DETYRIMET DHE KAPITALI			
I. Detyrimet afatshkurtra			
1. Huatë afatshkurtra	11	682,508,695	402,707,494
2. Llogari te Pagueshme		2,302,510,073	5,035,077,701
3. Detyrime ndaj shtetit	12	47,465,559	18,363,472
4. Parapagime të arkëtuara		689,911,039	408,513,784
5. Të tjera detyrime afatshkurtra	13	32,389,530	26,986,796
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra (I)		3,754,784,897	5,891,649,247
II. Detyrimet afatgjata			
1. Huatë afatgjata		-	-
2. Huamarrje te tjera afatgjata		352,836,221	538,702,413
3. Llogari te Pagueshme Afatgjata		2,499,744,756	-
4. Parapagime afatgjata		751,005,843	2,267,152,718
5. Garanci te arketuara		84,773,841	68,450,160
Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		3,688,360,661	2,874,305,291
Totali i detyrimeve (I + II)		7,443,145,558	8,765,954,538
III. Kapitali			
1. Kapitali aksionar		2,374,534,400	1,581,049,000
2. Prime te lidhura me kapitalin		797,295,381	-
3. Rezerva statutore dhe ligjore		-	-
4. Rezerva te tjera		887	410
5. Fitimet e pashpërndara		-	-
6. Fitimi (humbja) e vitit financiar		330,659,774	217,689,477
Totali i Kapitalit (III)		3,502,490,442	1,798,738,887
TOTALI I PASIVEVE (I,II,III)		10,945,635,600	10,564,693,425

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

	Shenime	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
I. Te ardhurat			
1. Shitjet neto	14	7,594,833,775	6,759,277,806
2. Te ardhura te tjera	15	886,066,234	399,501,586
Total i te ardhurave		8,480,900,009	7,158,779,392
II. Shpenzimet			
1. Ndryshimet ne inventarin e PG & PPC		-	-
2. Mallrat, lendet e para dhe shërbimet	16	(6,367,498,441)	(5,107,310,846)
3. Shpenzime te tjera	17	(921,743,063)	(1,054,445,723)
4. Kosto e punes	18	(397,434,597)	(523,345,877)
5. Amortizimi dhe zhvleresimet	19	(360,058,419)	(265,948,551)
Totali i shpenzimeve		(8,046,734,520)	(6,951,050,997)
FITMI NGA VEPRIMTARIA KRYESORE (I+II)		434,165,489	207,728,394
III. Te ardhura & shpenzime financiare			
1. Te ardhura dhe shpenzime nga interesi	20	(27,442,010)	(31,018,987)
2. Fitimet/humbjet nga kursi I kembimit	21	(23,776,245)	82,894,775
3. Te ardhura & shpenzime te tjera financiare		6,685,400	921,419
Totali i te ardhura & shpenzime financiare		(44,532,854)	52,797,207
FITIMI PARA TATIMIT (I+II+III)		389,632,635	260,525,601
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	22	(58,972,861)	(42,836,124)
FITMI NETO I VITIT FINANCIAR		330,659,774	217,689,477

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE**Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017**

	Viti Ushtrimor	Viti Ushtrimor
	31.12.2017	31.12.2016
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shrytezimit		
1. Fitimi para tatimit	389,632,635	260,525,601
2. Rregullime per Amortizimin	360,058,419	265,948,551
3. Rritje /Renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme	2,577,285,587	1,047,359,860
4. Rritje /Renie ne tepricen e inventarit	349,265,599	(73,336,393)
5. Rritje /Renie ne tepricen e detyrimeve	(1,195,915,650)	(703,642,570)
MM neto nga aktiviteti i shfrytezimit	2,480,326,591	796,855,049
II. Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
1. Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale		
2. Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(3,611,429,084)	(92,627,042)
3. Ta ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
4. Interesi I arketuar	-	-
MM neto, perdorur ne aktivitetet investuese	(3,611,429,084)	(92,627,042)
III. Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
1. Hyrje nga rritja e kapitalit aksioner	1,373,091,781	(15,247,025)
2. Hyrje nga huamarrje afatgjata	-	(41,946,784)
3. Hyrje nga huamarrje te tjera afatgjata	(185,866,192)	(742,086,872)
MM neto e perdorur ne aktivitetet financiare	1,187,225,589	(799,280,681)
Rritja /renia neto e mjeteve monetare	56,123,095	(95,052,674)
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	192,423,375	287,476,049
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	248,546,471	192,423,375

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali aksionar	Primi I aksionit	Aksionet e thesarit	Rezerva statutore dhe ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i pashperndare	Totali
Pozicioni me 1 Janar 2017	1,581,049,000	-	-	410	-	217,689,477	1,798,738,887
Emetim i kapitalit aksioner	-	-	-	-	-	-	-
Dividendët e paguar	-	-	-	-	-	-	-
Rritje me kontribute te tjera	575,796,400	797,295,381	-	-	-	-	1,373,091,781
Rritje e rezervës së kapitalit	217,689,000	-	-	477	-	(217,689,477)	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	-	-	-	-	330,659,774	330,659,774
Pozicioni me 31 Dhjetor 2017	2,374,534,400	797,295,381	-	887	-	330,659,774	3,502,490,442

Bashkim ULAJ
Administrator



Sonila IMERAJ
Drejtor Finance

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Informacion i Pergjithshem

Organizimi

Shoqeria "GENER-2" sh.p.k. është krijuar si shoqeri me përgjegjësi të kufizuar, me Vendim të Gjykatës Tiranë Nr.30145 dt.03.09.2003, me seli në Lezhë (Mamurras). Shoqeria është regjistruar pranë organeve tatimore me numrin unik të identifikimit K58615301M.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Objekti dhe Kontributet

Shoqeria "GENER-2" sh.p.k ka si objekt veprimtarinë në ndërtim, import-eksport, tregtim artikuj të ndryshëm, administrim qendër biznesi, etj.

Në vitin 2017 kjo shoqeri ka ushtruar aktivitetin e saj në ndërtim për të tretë, ndërtim objekte banimi, ndërtim e furnizime të tjera si dhe shitje mallrash në qendër tregtare, venie në shfrytëzim e qendrës së biznesit, etj.

Kontributi në shoqeri përfaqësohet nga kapitali i 3 ortakëve, për të cilët detajet e plota janë paraqitur në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Pronesia mbi Aktivet

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj në ambiente ndërtimi dhe qendër biznesi. Aktivet e saj përbehen nga: ndërtesa, makineri e pajisje pune, mjete transporti, pajisje zyre dhe informatike.

Kapitali

Kapitali i shoqërisë prej 2,374,534,400 leke është kapitali i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrimi

Shoqeria drejtohet nga Administratori z.Bashkim Ulaj, të cilit i perkasin të gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv të përgjithshëm.

2. Politikat kryesore kontabile

2.1 Bazat e përgatitjes

Deklarimet financiare të bashkangjitura janë përgatitur në baze të regjistrimeve kontabel të mbajtura për qëllime të kontabilitetit të vendit konform Ligjit 9228 datë 29 Prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Pasqyrat Financiare të fund vitit janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standartet Nderkombetare të Kontabilitetit në fuqi (SNK).

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Përgatitja e pasqyrave Financiare në përputhje me kërkesat e SNK, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabile të rendesishme. Kjo gjithashtu kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të japë gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile të saj. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rendesishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjten periudhë kontabel si dhe të ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me anë të një programi të kontabilitetit.

Deklarimet financiare janë shprehur në Leke, e cila është monedha shqiptare.

Një përmbledhje të pjesës me të madhe të politikave kontabel mbi bazën e të cilave janë përgatitur deklarimet financiare janë paraqitur sa më poshtë:

2.2 Instrumentat financiarë

Kompania ka vetëm instrumenta financiarë jo derivativë, përfshirë dhe kërkesa nga kliente dhe kërkesa të tjera, mjete likuide dhe të ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe të tjera detyrime.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen, fillimisht, me vlerën e drejte plus, çdo kosto të drejtperdrejte transaksioni të lidhura me to, përveç atyre të pershkruara më poshtë. Në vazhdim të njohjes fillestare instrumentat financiarë vlerësohen si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse kompania është pale në kushtet e kontratës. Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat e Kompanisë mbi rrejdhat e ardhshme të parase të gjeneruara nga aktiviteti financiar kanë mbaruar ose nëse kompania i transferon aktivitetet financiare një pale të tretë pa mbajtur të drejtat e kontrollit ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga aktiviteti. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet në datën e shitblerjes psh. datën në

te cilen kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me nese detyrimet e Kompanise e specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anulohen.

Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

Detyrime te pagueshme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

Huate bankare dhe te tjera

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur çdo difference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

Te tjera

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metoden e interest efektiv, minus cdo humbje nga zhvleresimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve fianciare sqarohet ne piken 2.8.

Aktivitet fianciare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur kompania ka te drejte te pakushtezuar te ndryshoje marreveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

2.3 Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësi ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore te objektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar.

2.4 Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivët Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit është mbi bazën e metodës zbritëse.
Toka dhe Ndertimet në Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabel. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Ne bilanc Aktive Afatgjata Jo Materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

2.6 Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Kuota njihet me vlerën nominale 2,374,534 leke secila.

2.7 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile të aktiveve jofinanciare të Kompanisë, përveç inventareve dhe tatimeve të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim.

Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabile e një aktiviteti është më e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti është më e madhja mes vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në matjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme të parase skontojnë në vlerën e aktuale duke përdorur normën e skontimit përpara takses që paraqet vlerësimin e tregut për vlerën në kohë të parase dhe riskun specifik të aktivitetit.

Për humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohet në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues sipas të cilit humbja është ulur ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kanë ndodhur ndryshimet në vlerësimet e bera për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë që vlera kontabel e aktiveve të mos kalojë vlerën kontabel të aktiveve, minus amortizimin, që do të ishte përcaktuar nëse zhvlerësimi nuk do të kishte ndodhur.

2.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktivi financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si difference midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te flukseve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive fianciare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjeter e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anulohet nese ajo mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi njohjes se zhvleresimit.

Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anullimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

2.9 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjate aktivitetit të zakonshem të Kompanise.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

2.10 Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

2.11 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet

valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

2.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit që pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore që zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese.

Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si difference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet që jane ne fuqi, që pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë.

Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2.13 Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne Leke (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne datën e kryerjes se transaksionit.

Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve në monedhe të huaja dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve në monedhe të huaja me kursin e kembimit të fund-vitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit për monedhat me transaksionet me materiale janë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
EURO	132.95	135.23
USD	111.10	128.17

3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve të bilancit

Çelja e vitit 2017 rakordonte me mbylljen e vitit 2016.

4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Aktivet monetare përfshijnë vlerat në arke e banke, investime afatshkurtra që janë shumë likuide dhe të konvertueshme në vlera të njohura monetare dhe vetëm me një humbje jomateriale në vlerë monetare.

Aktivet monetare në bilanc i korrespondojnë vlerave të mjeteve monetare të përcaktuara si më sipër dhe detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Arka	6,946,905	14,685,382
Banka	240,299,566	176,437,993
Letra me vlerë	1,300,000	1,300,000
Totali	248,546,471	192,423,375

5. Inventare

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten detajet në lidhje me kategoritë e inventareve më 31.12.2017 dhe 31.12.2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Materiale të para	50,264,188	468,517,603
Mallra	628,557,261	497,914,549
Parapagesa për furnizime	122,640,725	184,295,620
Totali	801,462,174	1,150,727,772

6. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe Shpenzime të shtyra përfaqësojnë shpenzimet për projekte dhe taksa të objekteve në proces ndërtimi për vetë dhe për të tretet.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten detajet në 31.12.2017 dhe 31.12.2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime të projekteve në ndërtim	652,320,553	312,216,488
Shpenzime të projekteve të pafilluara	191,353,428	114,677,277
Garanci qeraje	834,609	834,609
Totali	844,508,590	427,728,374

7. Llogari të arketueshme (Klientet)

Një prezantim sipas kategorive të klientëve në 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Objekte në Ndërtim	616,419,633	2,602,355,188
Kliente nga shitja e objekteve	47,076,605	153,267,936
Kliente tendera ndërtimi	2,053,230,244	3,083,647,274
Kliente (ABA + Toptani)	165,373,387	50,673,056
Kliente Coin	39,363,023	35,209,542
Kliente të tjere	18,046,113	8,910,744
Totali	2,939,509,005	5,934,063,741

8. Te tjera të arketueshme

Llogari të tjera të arketueshme për gjendjen e tyre në 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari të perkohshme në pritje	0	4,621,455
Garanci Rentat Minerare	5,361,849	0
Te Arketueshme të tjera	449,590	569,422
Totali	5,811,439	5,190,877

9. Aktive afatgjata materiale

Shoqëria ka një vlerë neto të aktiveve afatgjata materiale 5,720,842,547 lekë dhe është vlerësuar me koston e marrjes së tyre zbritur amortizimin. Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur detajet për levizjet e aktiveve afatgjata materiale dhe amortizimin sipas kategorive, për 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016:

	Toka	Ndertesa & Instalime	Makinëri & Pajisje	Mjete Transporti	Aktive të Tjera	Totali
<i>Aktive të Trupezuara</i>						
Gjendje 01.01.2017	75,406,000	1,953,393,815	951,768,046	322,866,507	391,763,741	3,695,198,109
Shtesa	793,414,270	2,598,105,402	161,077,916	-	67,355,589	3,619,953,177
Pakesime	-	-	(2,041,589)	(12,566,614)	-	(14,608,203)
Gjendje 31.12.2017	868,820,270	4,551,499,217	1,110,804,373	310,299,892	459,119,330	7,300,543,083
<i>Amortizimi</i>						
Gjendje 01.01.2017	-	377,132,886	502,915,799	109,694,176	236,351,727	1,226,094,588
Amortizimi i AAM i vitit 2017	-	173,386,772	100,818,543	42,048,033	43,436,710	359,690,058
Pakesimi i Amortizimit 2017	-	-	-	(6,084,110)	-	(6,084,110)
Gjendje 31.12.2017	-	550,519,658	603,734,342	145,658,099	279,788,437	1,579,700,536
<i>Vlera neto 01.01.2017</i>	75,406,000	1,576,260,929	448,852,247	213,172,331	155,412,014	2,469,103,521
<i>Vlera neto 31.12.2017</i>	868,820,270	4,000,979,559	507,070,031	164,641,793	179,330,893	5,720,842,547

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale është llogaritur sipas normave të nenit 22 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatinin mbi të ardhurat” në vlerë 359,690,058 lekë, vlerë e cila është njohur në shpenzimet e vitit.

10. Aktive afatgjata jomateriale

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Program kompjuterik - Vlera Bruto	6,364,167	6,364,167
Amortizim i Akumuluar	(5,259,079)	(4,890,717)
Amortizim i Vitit	(368,362)	(368,362)
Vlera Neto 31.12.2017	<u>736,726</u>	<u>1,105,088</u>

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat" ne vlere 368,362 leke, vlere e cila eshte njohur ne shpenzimet e vitit.

11. Huate afatshkurtra

Huate afatshkurtra perbehen nga shuma e overdrafteve dhe kredite afatshkurtra marre nga bankat e nivelit te dyte ne Shqiperi. Detajet per gjendjen me 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Overdraftet	665,609,468	361,387,133
Pjesa Afatshkurter e Huase Afatgjate	0	41,320,361
Hua Afatshkurtra	16,899,227	0
Totali	<u>682,508,695</u>	<u>402,707,494</u>

12. Detyrime ndaj shtetit

Detyrime ndaj shtetit perfaqeson kryesisht shumen e detyrimeve per sigurimet shoqerore & shendetesore si dhe tatimin mbi te ardhurat personale, qe i perkasin pagave te muajit dhjetor 2017. Keto detyrime jane paguar sipas dispozitave ligjore ne Janar 2018. Gjithashtu detyrimi per taksat vendore dhe tatimin fitimin jane paguar ne 3-mujorin e pare te vitit 2018.

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Sigurime shoqerore	8,785,057	8,033,238
Tatim Page	1,457,847	1,536,589
TVSH	2,850,406	1,174,029
Tatim Fitimi	2,387,949	359,316
Tatim ne burim	9,690,079	3,439,201
Renta Minerare	0	3,821,100
Taksa Vendore	22,294,221	0
Totali	<u>47,465,559</u>	<u>18,363,472</u>

13. Te tjera detyrime afatshkurtra

Te tjera detyrime afatshkurtra, perfaqesojne pagat per t'u paguar qe i perkasin muajit dhjetor 2017, te cilat jane paguar ne Janar 2018.

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Te Pagueshme ndaj Punonjesve	32,389,530	26,986,796
Totali	32,389,530	26,986,796

14. Shitjet neto

Shoqeria per vitin 2017 ka realizuar shitje neto, detajuar si me poshte :

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Shitje produkt i gatshem	105,171,821	754,162,814
Shitje mallra qendra tregtare	741,407,232	772,335,634
Shitje ndertimi objekte banimi	998,614,411	239,586,373
Shitje ndertimi per te trete	5,746,029,245	4,993,192,984
Te tjera shitje materiale	3,611,067	0
Totali	7,594,833,775	6,759,277,806

15. Te ardhura te tjera

Shoqeria per vitin 2017 ka realizuar te tjera shitje e sherbime, detajuar si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Qerate & sherbim Qendrat e Biznesit	872,000,806	348,132,486
Qera Veshjesh + Komisione Coin	7,369,911	44,757,343
Shitje AAM	4,296,752	125,000
Te Ardhura te Tjera	2,398,766	6,486,756
Totali	886,066,234	399,501,586

16. Mallra lende te para dhe sherbime

Ne kete ze perfshihen shpenzimet per lende te para, taksa doganore e shpenzime transporti per lemdet e para dhe mallrat dhe sherbime ndertimore nga te trete, detajuar si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Shpenzime Materiale	4,390,574,050	1,861,191,447
Punime nga Nenkontraktoret	1,437,788,955	2,683,541,714
Mallra per shitje (Coin)	539,135,436	562,577,685
Totali	6,367,498,441	5,107,310,846

17. Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet, detajuar si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Shpenzime energjie	105,749,129	55,301,381
Shpenzime qeraje	112,419,073	240,034,496
Mirmbajtje dhe riparimi	104,494,425	61,529,513
Prime te sigurimit	29,750,600	17,729,647
Udhetim & hoteleri	49,846,879	56,367,795
Sherbime te tjera	357,802,224	512,508,746
Reklama Publicitet	39,269,148	30,451,488
Shpenzime postare, telekomunikac, transport	23,438,489	20,214,150
Sherbime bankare	17,788,416	14,072,236
Taksa	66,933,281	31,995,230
Penalitete & shp. me dok.jo te regullta	3,267,811	11,088,150
Sponsorizime& dhurata	2,459,496	1,205,261
Vlera kontabel AQT te shitura	8,524,093	1,947,630
Totali	921,743,063	1,054,445,723

18. Shpenzime te personelit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore, detajuar si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Paga	340,714,533	448,402,152
Sigurime shoqerore	56,720,064	74,943,725
Totali	397,434,597	523,345,877

19. Amortizimi dhe zhvleresimet

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat".

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Amortizimi I AAM (Shiko noten 9)	359,690,057	265,580,189
Amortizimi I AAJM (Shiko noten 9)	368,362	368,362
Totali	360,058,419	265,948,551

20. Te ardhura dhe shpenzime nga interesi

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi, per vitin ushtrimor 2017 dhe 2016, paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Te ardhura nga interesat	61,773	42,386
Shpenzime per interesa	(27,503,783)	(31,061,373)
Totali	(27,442,010)	(31,018,987)

21. Fitim / humbjet nga kursi i kembimit

Fitim / humbjet nga kursi i kembimit, per vitin ushtrimor 2017 dhe 2016, paraqiten si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Fitime nga kembimet valutore	103,167,079	112,692,749
Shpenzim nga kembimet valutore	(126,943,324)	(29,797,974)
Totali	(23,776,245)	82,894,775

22. Llogaritja e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatim fitimit jane llogaritur sipas dispozitave ligjore tatimore ne daten e mbylljes se bilancit. Detajet e llogaritjeve jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Fitimi Bruto	389,632,635	260,525,601
Humbje e mbartur	0	0
Shpenzime te pa njohura	3,519,774	25,048,561
Baza e llogaritjes Tatimit	393,152,410	285,574,162
% e Tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	58,972,861	42,836,124
Fitimi NETO	330,659,774	217,689,477

23. Vijimesia

Kompania deklaroi qe nuk ka problem me vijimesine e aktivitetit.